REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA POGRADEC**
**KESHILLI**

Nr. 4062/prot. Pogradec, më 11.11.2025

**VENDIM**

**Nr. 111, DATË 10/11/2025**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 34 HA DHE 6600 m2, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇËRRAVË QË MUND TË JEPEN ME QIRA.**

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë listën e siperfaqes së tokës bujqësore prej **34** Ha (Tridhjete e kater) dhe **6600 m2** (gjashtemije e gjashteqind),të ndodhur në Njësinë Administrative Çërravë, që mund të jepen me qera sipas listës.

| Nr | Pronesia | Zona Kadastrale | Nr Pasurise | Vendodhja | Lloji | Siperfaqja ne m2 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Shtet | 1387 | 348 | Çërravë | Pa Fruteshme | 16400 |
| 2 | Shtet | 1387 | 84/2 | Çërravë | Pemëtore | 330200 |
| | | | | | TOTALI | 346600 |

2. Toka Bujqësore që do të jepet me qera do te shfrytëzohet vetëm për veprimtari bujqësore dhe te tjera veprimtari ne funksion te saj, qe lejohen ne token bujqesore.
3. Afati i dhënies me qera do të jetë në përputhje me destinacionin e kultivimit por asnjëherë më i gjatë se afati i përcaktuar pikën IV të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara", dhe percaktimeve te tjera ligjore.

[1]Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

4.Çmimi dysheme i vlerës së qerasë nuk do te jete jo më pak se 6000 (gjashtëmije) lekë Ha në vit sipas pikës nr 10 të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".

5.Per zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Çështjeve Juridike, si dhe Njësia Administrative Çërravë.

6.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

**KRYETARE E KËSHILLIT**

**Manjola KAMOLLI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

**1.Miratuar me 19 vota**

**2.Vota Pro 19**

**3.Vota Kundër 3**

**4.Vota Abstenim 2**

**5.Zbardhur më date 11.11.2025**